



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS
01.Nr. 06-3544/17
KLINË, 26.5.2017

PROCESVERBAL

I SEANCËS SË V-të TË KUVENDIT TË KOMUNËS, MBAJTUR, MË 25.5.2017, NË ORËN 10:00, NË SALLËN E KK

Në seancë prezantuan: Kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, nënkryetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e KK, drejtorë të drejtorive, Zyra ligjore, përfaq. të KFOR-i, përfaq. të OSBE-së, Policia e Kosovës, Engjëll Prenaj, zv. komandant i Policisë në Klinë, Zyra për Informim, OJQ “Koha” etj.

Mbledhjen e hapi dhe udhëhoqi kryesuesi, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit për pjesëmarrje në këtë seancë të KK.

“Nga Ministria e financave na ka ardhur një qarkore me sugjerimin që rishikimin e buxhetit të Komunës për vitin 2017, për ta përfshirë në rend të ditës për miratim. Për t’i ikur mbajtjes së një seancë të jashtëzakonshme kemi paraparë që këtë çështje ta përfshimë si pikë e rendit të ditës për këtë seancë, propozoj Rishikimin e buxhetit për vitin 2017, a ka pajtueshmëri që ta fusim si pikë e rendit të ditës? Materiali është i gatshëm për shpërndarje, posa të vendoset për t’u përfshirë në rend të ditës gjatë seancës mund ta bëjmë shpërndarjen e këtij materiali”, theksoi kryesuesi Ibishi, i cili në vijim kërkoi nga shefat e grupeve të anëtarëve që të deklarohen.

Halil Desku, tha se ne jemi që të procedohet sot.

Arben Limani, pohoi se pa material nuk jemi për procedim të kësaj pike të rendit të ditës.

Haxhi Ibishi, theksoi se pa hyrë si pikë e rendit të ditës nuk ka mundësi të shpërndahet materiali.

Tunë Dedaj, tha se shpeshherë po përsëritet e njëjta gjë, nuk e di arsyen pse është bërë kështu, por grupi im nuk e mbështet, ndërkaq unë personalisht e mbështes.

Skënder Merturi, tha se nuk jam i pajtimit që kjo të futet si pikë e rendit të ditës.

Ndue Shabanaj, tha se unë jam për të proceduar, por çështja është prej momentit kur është pranuar materiali deri sot, a ka pasur hapësirë të njoftohemi, apo jo? “Nëse jo, kjo domethënë

është jashtë kompetencës së pushtetit lokal, që ka ardhur prej nivelit qendror dhe, realisht ne nuk mund ta ndryshojmë, nëse është afati i fundit sot. Atëherë, realisht nuk ka rrugë tjetër. Përkundër të gjithave jam për të proceduar, për të mos qenë pengesë për ta kaluar këtë pjesë”, theksoi prof. Shabanaj.

Fadil Gashi, tha se ne e thamë vetëm një “jo”, por tash po bëj përpjekje për ta arsyetuar “Jo-në”, sepse nuk do me thënë as atë që përmende ti kryesues, Podujeva, Istogu, që janë më të mençur, këtu kemi të bëjmë me procedurat ligjore, nuk mund ta fusësh një pikë të rendit të ditës pa pasur material, pikë. “Kështu e ka thënë ligji, nuk mund ta thuash ti as ne, edhe nuk ka institucion që të detyron. Nëse një ministri ka ardhur në këtë gjendje ose në këtë shkallë të na përfshijë krejt këtë kuvend për të shkelur çdo procedurë ligjore ose rregulloren e punës, nuk ma merr mendja që ka këtë mandat asnjë ministri, as kjo e lindjes në fjalë. Edhe është absurd për të rënë ne në këso nivele, “na kanë thënë ata sot”, por nuk mundet për të na detyruar për të bërë shkelje. Kjo është me rëndësi. Pa një material është absurd për të hyrë në rend të ditës, kjo është”, ka theksuar anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se materialin ju shpërndajmë sapo të hyjë në rend të ditës.

Pjetër Coli, tha se meqë është dita e fundit edhe duhet të procedohet, mirëpo pa pasur asnjë material nuk është e lehtë për neve që ta bindim vetveten. “Unë kisha propozuar që t’i kalojmë këto pika të rendit të ditës, të na shpërndahet materiali, me një pauzë prej një ore, atëherë për të vazhduar”, tha anëtari Coli.

Haxhi Ibishi, tha se ne mund ta përfshimë si pikë të rendit të ditës, ndërkohë menjëherë materiali do t’i jepet secilit, proceduralisht kështu zhvillohet, pastaj bëjmë pauzë edhe si pikë të veçantë e përfshimë rishikimin e buxhetit për vitin 2017.

“Me dakordancë të të gjithëve mund ta ndërpremë për një orë seancën, materialin ju shpërndaj në këto momente dhe vazhdojmë në orën 11 pa problem, vetëm të jemi të gjithë unikë për arsye se është qëndrim i MF në këto raste është një rekomandim i tyre që të përshpejtohen disa procedura për arsye se Kuvendi nuk dihet kur do të konstituohet. Po e përfshimë si pikë e rendit të ditës. Materialin po e shpërndajmë”, theksoi kryesuesi Ibishi.

Tunë Dedaj, tha se nuk po e shoh të arsyeshme të shtyhet seanca kot, do të thotë është tërësisht kot, mos mendoni që kam pasur lehtë ndoshta unë për ta ngritur dorën kundër interesit të subjektit tim politik. “Nuk është në rregull që disa gjera vetëm duhet kaluar, gjegjësisht domosdoshmërisht duhet kaluar. Por, nuk pengohet zhvillimi i Komunës me rishikim të buxhetit. Unë nuk po e shoh të arsyeshme këtë shtyrje të seancës, kur ai kalon. Për të mos votuar ne asnjë numrat janë”, tha anëtari Dedaj.

Me vota unanime u miratua propozimi që në rend të ditës të futet, Rishikimi i buxhetit të Komunës së Klinës për vitin 2017.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e propozuar të ditës dhe propozimin për një pushim një orësh.

Me vota unanime u miratua ky

REND I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar-mars 2017 (ref. Drejtoria e FEZH).
4. Rishqyrtimi i Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Rinore në Klinikë ngastrë nr. 587/2 ZK Klinikë (sipas kërkesës së MMPH të dt.02.05.2017 nr. 1969-2/17).
5. Rishikimi i buxhetit të Komunës së Klinikës për vitin 2017.

Me seancë u procedua në ora 11.20 minuta.

Haxhi Ibishi, tha se po procedojmë, prezent në sallë jemi 22 anëtarë komunalë, kemi kuorum, vazhdojmë me rendin e ditës.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Haxhi Ibishi, tha se nuk kam asnjë me arsyetim, përpos që ishte Avniu, i cili tha se bashkëngjitem më vonë.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Fadil Gashi, tha se unë e pashë këtë pjesën e procesverbalit, por tash, nuk kam vërejtje kështu qysh është shkruar, por kam vërejtjen qysh na kishit klasifikuar, do të thotë do të ishte mirë për të na sqaruar, ti Kryesues i pari, për proces tash. “Nuk qëndron ajo, që unë kah jam dalë në korridor, shumë sinqerisht ka qenë, vetëm nëse dëshironi për të mos pranuar, keni qenë ti dhe kryetari, kam thënë “po dalim me pirë nga një kafe kur të bëheni gati po kthehem”. Kështu ka qenë fjala ime. Edhe është jo e sinqertë nëse nuk e pranoni se ka qenë kështu. Prandaj, të mos mbetet që ne kemi dalë prej seancës, këtu në proces qysh e keni thënë, por kemi dalë për të pirë nga një kafe me kuptimin kur të fillohet ne me ardhur. Domethënë, këtë përmirësojeni dhe ju qysh e kishit thënë “s’kanë arsye me dalë”, nuk e kemi lëshuar herën e parë, e kemi lëshuar herën e dytë seancën, sepse ne nuk kemi pasur si ta lëshojmë pa filluar seanca, a ka logjikë?! Pa filluar keni thënë “e kanë lëshuar”!- ka konstatuar anëtari Gashi.

Vuri në miratim procesverbalin me ndryshimet e propozuara nga anëtari Gashi.

Me 21 votë për, 1 abstenim u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të menaxhimit financiar komunal për periudhën janar-mars 2017 (ref. Drejtoria e FEZH).

Haxhi Ibishi, tha se është krijuar një praktikë, që e mirë që çdo tre muaj DF përmes drejtorit z. Rrusta me kohë na sjell raportin financiar. “Raportin e kemi shqyrtuar edhe në KPF”, theksoi kryesuesi Ibishi, i cili në vijim fjalën e barti te DF, z. Ramiz Rrusta.

Haxhi Ibishi, tha se kam një deklaratë, unë kërkoj falje, por tash e vërejtja, këshilltarja Gashi ka për të bërë një deklaratë, e cila, thjesht është individuale.

Rukije Gashi, tha se për shkak të disa ndryshimeve që kanë ndodhur kohëve të fundit dhe për shkak që shumica juaj veç e dini bashkëshorti im ka kaluar nga PDK në partinë “Nisma”, unë e ndjej si obligim moral që të jap dorëheqje nga anëtarja e PDK-së dhe të kalojë si kandidate e pavarur deri në fund të mandatit. Ju faleminderit për të gjitha, për përkrahjen, për bashkëpunimin, për të gjithë që deri me tani kemi pasur bashkërisht. Edhe një herë, ju faleminderit!”, është shprehur anëtarja Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se e respektojmë në plotni vendimin tuaj, është vendim autonom, i bazuar në kushte dhe rrethana që ju keni vlerësuar dhe besoj që ne do të bashkëpunojmë edhe më tutje. “Ju jeni këtu anëtare e KK dhe do të keni qasje në të gjitha institucionet qysh keni pasur, respektojmë vendimin tuaj”, pohoi kryesuesi Ibishi.

Ramiz Rrusta, tha se edhe unë i bashkëngjitëm urimit për zonjën Gashi për ta dhënë kontributin kudo që të jetë.

“Kemi biseduar edhe në KPF , janë këtu anëtarët e KPF-së. Dua të paraqes një raport të shpenzimeve për periudhën tremujore dhe besoj që është raport real. Besoj që përkundër materialit që ju erdhi, thashë për rishikim të buxhetit, këtë material e keni përpara dhe për të analizuar realizimin e buxhetit për këtë periudhë 2017 ne do të japim pasqyrat buxhetore të të hyrave, shpenzimeve; të analizojmë trendët të këtyre kategorive buxhetore dhe krahasimet me parametrat buxhetorë për të krahasuar me periudhën paraprake. Dihet fare mirë që të buxheti sipas sistemit të menaxhimit të financave të RK për këtë 2017 është 8,721,687.33 euro në krahasim me buxhetin për vitin e kaluar që ishte 85 57937, çka do të thotë që buxheti është është më i madh në këtë vit për 1.91 për qind në krahasim me vitin e kaluar. Në tab. nr. 4 keni buxhetin sipas burimit dhe buxhetin e shpenzuar në këtë periudhë tremujore, ku buxheti i shpenzuar në këtë periudhë është 1,660,060.40 apo 19.3 për qind krahasuar pra për këta tre muaj. Nga Granti qeveritar janë shpenzuar 162935 euro apo 21 për qind në raport me buxhetin nga granti Të hyrat vetanake 282044 apo 2.74 për qind në raport me buxhetin nga të hyrat; nga donacioni save dhe Children kemi 2780 euro apo 100 për qind të shpenzuar nga ky donacion. Buxheti i shpenzuar në këtë periudhë është 1 660. 60.44 euro apo krahasuar me shpenzimet për periudhën e njëjtë të vitit 2016 në vlerë 1,891,214.78 € janë zvogëluar për rreth 12.22 % . Shpenzimet për paga dhe mëditje krahasuar me vitin paraprak që ka qenë 1891214 euro, pra për minus 12 . 22 për qind kemi më pak buxhet të shpenzuar krahasuar me tre muajt e vitit të kaluar. Shpenzimet e buxhetit për këtë periudhë tremujore sipas kategorive ekonomike: për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1 413 244 euro, krahasuar me vitin e kaluar është minus 0.06 për qind më pak; për mallra dhe shërbime, në këtë periudhë janë harxhuar 133 836 euro, ndërsa në periudhën e kaluar janë shpenzuar 155 830 euro, d.m.th minus 14.11 për qind më pak; për mallra dhe shërbime janë zvogëluar për 14.11 %, shërbimet komunale në këtë periudhë janë harxhuar 51,000 euro, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka qenë 44 965 euro apo 13. 42 % , shpenzimet për subvencionet dhe transferet në periudhën tremujore janar-mars 2017 janë shpenzuar 2 568 euro, ndërsa e njëjta kategori e subvencioneve në vitin e kaluar janë shpenzuar vetëm 350 euro apo 633, apo në përqindje del 83 %. Unë me anëtarët e KPF-së kemi biseduar, e kanë kërkuar listën e atyre që janë përfitues të subvencioneve, mund t'i lexoj tash apo më vonë.

Tek kapitalet në periudhën janar mars 59 410 euro janë shpenzuar do të dhënë e njëjta periudhë e vitit të kaluar janë shpenzuar 275 807 euro apo minus 78.46 %. Çka thashë edhe në fillim që buxheti është shpenzuar më pak për minus 12.22 për qind. Të hyra të realizuar në këtë periudhë tremujore kemi trafikimin atje, pa marrë parasysh edhe pa u koduar në buxhet të dënimet nga gjykata, sepse diku për tre mujor po vijnë në janar-mars apo prill, por mund të shihni në raportin 6-mujor, prapë se prapë nga të hyrat vetanake për këtë tremujor në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi 54 760 euro të hyra më shumë se e njëjta periudhë tremujore për këtë vit. Te shpenzimet i keni të specifikuar të gjitha kategoritë e shpenzimeve. Anëtarët e KPF-së kanë nga një kopje edhe shpenzimet të specifikuar për të gjitha drejtoritë në një form at të zmadhuar, besoj që i keni edhe ju, ndoshta në format më të zvogëluar, kështu që unë i kam 4-5 kopje dhe jam i gatshëm me ju ofruar secilit”, ka theksuar drejtori Rrusta.

Arben Limani, tha se e përcollëm me vëmendje raportin financiar të menaxhimit dhe një vërejtje që desha për ta bërë në këtë raport se mungon krahasimi i detajizuar i shpenzimeve të vitit 2016. “Këtu është bërë një krahasim i shpenzimeve të vitit 2016 në periudhat e njëjta, mirëpo mungon në detaje qysh është bërë tej të hyrat komunale. Domethënë këtë sqarim mundësisht le të na jep drejtori i financave. Edhe tek subvencionet për entitete jo publike, në një nga seancat e kaluara e kemi kërkuar si grup i asamblistëve që të na sillen një listë me të gjithë ata persona që kanë përfutur nga kjo kategori, domethënë e subvencioneve jo publike.

Ramiz Rrusta, iu përgjigje anëtarëve të AK. Drejtori Rrusta, tha se edhe anëtarët e KPF kanë kërkuar, sepse ka dalë përqindja shumë e shpenzuar e subvencioneve për periudhën janar-mars 2017, krahasuar me janar – mars 2016. “Derisa në atë periudhë janë shpenzuar vetëm 350 euro, në këtë periudhë janë 2568 euro. Prej kësaj shume janë shpenzuar 300 euro për të ndjerin Dulaman Gashi, 100 euro Hajdin Balaj, për mirëqenien e gruas 1500 euro, Sanije Zenunaj 300 euro, Skënder Idrizi 100 euro dhe Fata Rizviq 268 euro, çka e përfshin shumën prej 2568 euro. Kjo është pjesa që është ndihmuar kësaj kategorie të subvencioneve. Rreth shpenzimeve ne kemi raportuar në mënyrë sintetike, të përgjithshme. Aty mund t’i vëreni shpenzimet sa kanë rënë, sa janë ngritur, qoftë për mallra dhe shërbime, qoftë për kategoritë tjera komunale. Është një trend i rënies së shpenzimeve sidomos për kategoritë që edhe për ju, edhe për ne janë pak të ndjeshme, qysh kanë qenë shpenzimet e telefonave, të drekave zyrtare, të gjitha ju i keni të specifikuar edhe në raportin që ju kemi ofruar për drejtori”, ka sqaruar drejtori Rrusta.

Kryesuesi vuri në miratim Raportin e Menaxhimit Financiar janar – mars 2017.

Me 15 vota për, 10, abstenim dhe asnjë kundër, u miratua Raporti i Menaxhimit Financiar janar – mars 2017.

Pika e katërt: Rishqyrtimi i Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Rinore në Klinikë ngastra nr. 587/2 ZK Klinikë (sipas kërkesës së MMPH të dt.02.05.2017 nr. 1969-2/17).

Kryesuesi Ibishi foli rreth çështjes në rend të ditës. Fjalën e barti te zyrtari i Drejtorisë së Urbanizmit, z. Ali Gashi.

Ali Gashi, zyrtar i Drejtorisë së Urbanizmit sqaroi çështjen në debat. “Edhe në KPF e kemi sqaruar, është kthyer përmes një shkrese nga OPL-ja në bashkëpunim më MMPH, që të kthehet

në rishqyrtim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të kulturës. Kështu që ne i kemi ndërmarrë të gjitha. Ka qenë realisht një keqkuptim për arsye se ne kemi pasur takime të vazhdueshme me ZL të MMPH. Sido që të jetë ne kemi thënë që tash ky dokument ka rrjedhë normale dhe duhet të kalojë përmes asamblesë dhe ne do e respektojmë vendimin e AK. Ky është thjesht një përmirësim i vendimit. Ne e kemi dërguar edhe si draft, besoj që Grisha ju ka dorëzuar”, sqaroi zyrtari Gashi.

Fadil Gashi, tha që sido që të jetë ne kemi debatuar edhe në KPF. “Edhe atje jam përmbajtur te vota, mirëpo edhe këtu bashkë me grupin nuk duam ta votojmë “për”. E kemi votuar në të kaluarën kur e kemi marrë vendimin për ta ndërtuar, por nuk duam të bëhem pjesë, sepse nuk ka seancë që s’po na kthehet nga një vendim. Edhe me vëmendje i pashë dokumentet që këto kanë mundur të na vinë edhe në këtë seancë. Unë asgjë nuk pashë që ka dalë risi diçka vetëm se nuk janë kompletuar dokumentet, edhe nuk po qëndron ajo që “ata nuk po janë të dijshtëm”, qysh na u tha aty në KPF, por ata po dinë diçka, e ato që i kanë kërkuar ata e paskeni kompletuar edhe ju. A po shihni që s’po dalin të padijshtëm ata?! Por kanë kërkuar me harmonizuar me PZHU, qysh e pashë që ka ardhur plani, ka ardhur në ngastër, kanë ardhur krejt komplet. Sot kanë qenë, por tash për inat nuk po dua. Dhe ndoshta shërben në të ardhmen mos me na u kthye vendimet për çështje banale për që s’e kryejmë punën vetë ne”, ka theksuar anëtari Gashi.

Kryesuesi e vendosi në votim vendimin për rishqyrtim të vendimit për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës rinore në Klinë, ngastra nr. 587/2 ZK Klinë (sipas kërkesës së MMPH të dt.02.05.2017 nr. 1969-2/17).

Me 18 vota për, 5 kundër dhe 1 abstenim u miratua vendimi.

Pika e pestë: Rishqyrtimi i buxhetit për vitin 2017.

Haxhi Ibishi, tha se ne e morëm një shkresë më herët nga DF, thamë me vonesë, u dakordua të gjithë, por për hir të procedurave që janë në fuqi dhe thjeshtë që ministria gjegjëse ka kërkuar, ne e kemi futur si pikë të rendit të ditës. Kryesuesi kërkoj nga DF që të sqarojë shkresën.

Ramiz Rrusta, tha se unë e thashë edhe në fillim të seancës, që pa fajin tonë, kemi pasur afatin e fundit më 25 maj 2017 për të proceduar në MF, atje kemi bërë kërkesën, tash varet vetëm prej mendimit tuaj si anëtarë të AK. Domethënë, bartja e këtyre mjeteve bëhet prej mallrave dhe shërbimeve, pra këto lëvizin. Po e marr vetëm një shembull që keni. Kjo është bërë në dakordim me gjithë drejtorët dhe ata kanë parë që ndryshimi i mjeteve në një kategori të shërbimeve komunale po e zëmë ka tepëricë të shpenzimit të rrymës që mendoj nuk i shpenzojnë ato i kanë bartur në shpenzimet e ujit apo shpenzimet e mbeturinave. Pjesa më e madhe e këtyre lëvizjeve është bërë edhe në DKA. Në shërbimet sociale, shërbimet shëndetësore primare, te buxheti kemi pasur diku 4 500 euro, kanë qenë shpenzime ku ne zakonisht kemi me shërbimet kontraktuese një shumë tjetër që është për shpenzimet për anëtarësim, tash i kemi bartur te shpenzimet kontraktuese, sepse bëhen kontrata të ndryshme. Tjetra kemi Zyrëb komunale për komunitete, që kanë pasur pak mjete ata, iu kanë tepruar prej Zyrës për regjistrim të automjeteve në kategori tjetër i kanë qitur, te inspektorët gjithashtu, administrata, arsim fillor, arsim të mesëm, që janë me lëvizje përbrenda, sepse nuk cenon buxhetin. Nuk kemi tejkalim të buxhetit, nuk kemi shkurtim të buxhetit, por është duke u mbështetur në Ligjin mbi menaxhimin e

financave dhe përgjegjësitë, pra 03L/048, që keni përpara dhe lexojeni, pra që duhet të jemi gjithçka me kohën.

Kryesuesi hapi diskutimin.

Arben Limani, tha se unë vetëm desha një sqarim nga drejtori i financave. “Këtu tek nënkategoria ekonomike, “shpenzimet për anëtarësim”, nëse ka mundësi një sqarime, domethënë. Edhe tjetra, “mirëmbajtja e ndërtesave” nënkupton bëhet fjalë për ndërtesat që menaxhohen nga Komuna, thjesht, objekti i Komunës dhe objektet tjera”, shtoi anëtarë Limani.

Ramiz Rrusta, tha se prej objektit të Komunës dhe gjithë objektet tjera, qofshin shkollat, ambulancat, salla e kulturës dhe gjitha këto. “Ne kemi pasur 45 000 euro, domethënë fatura e shpërndarjes së faturave të tatimit në pronë, e ka një vlerë më të madhe, ne kemi bartur këto mjete këtu për t’i paguar këtë kategori të faturave, përkatësisht të shpenzimeve”, sqaroi drejtori Rrusta.

Vlora Tafili, tha se uroj zonjën Rukije Gashi dhe suksese në karrierë. “Në emër të AAK-së veç u thanë shqetësimet dhe vërejtjet për mënyrën se si po silltet materiali, por mua personalisht po më intereson drejtor për transformimin apo riakolimimin nga projekti i kanalit të ujitjes në Zllakuqan dhe kanali për ujitje në Grabanicë. Më intereson të di a janë përmbushur të gjitha obligimet financiare apo çka ka ndodhur me këto shuma?”- ka shtuar anëtarja Tafili.

Enver Marmullaku, drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, sqaroi interesimin e anëtares Tafili. “Për kanalin Zllakuqan – Radulloc i kemi paraparë 300 mijë euro. Mirëpo ky kanal është kontraktuar në vlerë prej 27 444 euro, domethënë, tash kemi mbetje prej 2551, dhe kjo mbetje për të mos humbur ne e kemi për kanalin për fshatin Dellovë. Për arsye se aty kemi pak mjete, prej 18 000 euro dhe vlera e projektit është afër 30 mijë euro. Për të mos humbur këto mjete i kemi flokuar në këtë projekt. E njëjta gjë është edhe te kanali Grabanicë – Zajm, domethënë prej pendës së Ukë Sahitëve. Aty vlera e projektit ka qenë 35 000 euro, mirëpo është kontraktuar puna me 29 317 euro. Edhe këtu është marrë i njëjti hap që këto mjete të mos humbin, përkatësisht kalojnë në projektin e fshatit Dellovë dhe, domethënë, aty kemi 18 000 edhe tash kjo vlerë edhe kap shifrën 8 mijë e diçka euro, që kap shifrën 26 mijë që, domethënë, ai projekt përfundon tërësisht”, sqaroi drejtori Marmullaku.

Fadil Gashi, tha se desha të çështja e kanalit të ujitjes, një debat që dje është organizuar ka qenë edhe drejtori, më bëri përshtypje që ata që ua keni qitur kanalin kishin thënë që “ujët nuk po shkon përpjetë, se përpjetë keni qitur kanalet.

Enver Marmallku, tha se po që se ka mundësi të tregohet për cilin kanal bëhet fjalë, se për herë të parë po e dëgjoj këtu. “Nuk është mirë të shërbehemi me fjalë të rrugëve. Në cilin kanal nuk po shkon ujët, por po shkuaka përpjetë, këtë për herë të parë po e dëgjoj”.

Ramiz Rrusta, tha se unë kam qenë në një debat, falënderoj OJQ “Koha”, që ka organizuar, besoj që tash do të organizohet edhe në bashkësitë tjera lokale. “Kemi filluar me Bashkësinë lokale të Zllakuqanit, kanë qenë përfaqësues të asaj pjese atje dhe është biseduar për shqetësimet, që i kanë, i keni edhe ju, i kemi edhe ne, edhe të tjerët. Është biseduar për kanalet

për ujësjellësin dhe për krejt, është mirë për t'u sqaruar, për ku kanë pasur fjalën, mirë e pat drejtori se kanë thënë “paraja çon ujët përpjetë, shumë realitet. Ju mos çuditeni se ne edhe ujët e çojnë përpjetë, por të dihet se për ujësjellës është fjala. Aty është biseduar për kanalet e ujitjes, ju duhet për të na specifikuar për cilin kanal bëhet fjalë dhe drejtori do t’iu përgjigjet”, theksoi drejtori Rrusta.

Haxhi Ibishi, tha se ne kemi çështjen e rishikimit të buxhetit edhe vazhdojmë më tutje. “Ato janë sigurisht kualifikime tash të njerëzve”, pohoi kryesuesi.

Enver Marmullaku, tha se ne për herë të parë, Drejtoria e Bujqësisë, në mandatin tim, domethënë, në fshatin Jagodë kanë hyrë në tendë të ujitjes 200 hektarë dhe aty nuk ka pasur asnjë problem. “Po ashtu vjet është bërë në Krushevë të Madhe 1300 e diçka metra as aty s’ka pasur problem. Në këtë vit është duke u ndërtuar, akoma nuk ka përfunduar, projekti i Ministrisë së Bujqësisë në bashkëpunim me Komunën që e kap gjatësinë 4 225 metra, që nuk ka përfunduar akoma. Edhe tash kemi filluar një projekt tjetër në gjatësi 1 016 metra. Unë nuk e di, seriozisht është mirë të sqarohemi, përndryshe po ju tregoj ju mund të përballeni edhe me gjyq me mua. Me këso deklarata nuk kam dëshirë të përballem. Është për të thënë realitetin. Unë kur kam për të thënë diçka e them. Është mirë me thënë që filan kanali nuk po shkon ujët”, tha drejtori Marmullaku.

Fadil Gashi, tha se takimi ka qenë publik dhe jo larg, por dje. “merreni nëse ka incizuar dikush, unë s’kam qenë prezent, mua më kanë interpretuar, por i kemi pasur përfaqësuesit tonë aty, të LDK-së. E dyta, ka qenë publik, të gjithë kanë qenë keni pasur edhe përfaqësuesit e Komunës, njëri, bile në moshë të shtyrë është që e ka thënë, se nuk po e them unë, por pse nuk keni bërë keni bërë, ju e dini.. Ju 300 mijë euro i keni futur gypat në dhe, i keni nisur për Istog dhe s’ka ujë. I keni qitë 250 mijë euro gypat prej boka të Përqevës për Gllarevë dhe s’ka ujë. Nuk është hera e parë, në mund të ballafaqohemi, bile për gjyq jemi shumë të gatshëm”, tha anëtari Gashi.

Enver Marmullaku, tha se ndoshta dikë është duke e penguar se po shkojnë kanalet, seriozisht e kam, se e kemi tepruar pak atje. Dikë është duke e penguar, ndoshta. Se ne, unë si drejtor duhet për të dalë me stafin tim as nuk paguajnë qytetarët për projekte, as nuk paguajnë për financim të projektit, ne duhet të dalim se na dalin probleme që nuk e lë të kalojë kamionin, eskalatorin, ne duhet shkuar dhe për t’u futur nëpër llaç, normalisht dikë është duke e penguar kjo. Mua shumë po më vjen keq.

Fadil Gashi, tha se në mos je duke i dhënë parat tuaja?

Enver Marmullaku, tha se unë nuk i jap paratë e mia, Fadil, mirëpo dije se gjysma e Komunës po mbetet pa u përfshirë në projekte.

Fadil Gashi: “Mirë!”

Enver Marmullaku, tha se nuk është mirë se zyrtarja jote financiare, e partisë tënde, na pengon që projektet vetëm me kanal të ujitjes edhe penda po thotë ju s’keni të drejtë për t’i çuar tjetër kah, për arsye se projektet për sera, për makina mbjellëse etj., po thotë nuk bën prej mjeteve të të hyrave kapitale, jo ndodh vetëm në Komunën e Klinës.

Haxhi Ibishi, tha që të kthehemi në rendin e ditës, nëse ka ndokush rreth rishikimit të buxhetit le të urdhërojë.

Nuk pati të paraqitur për debat.

Kryesuesi vuri në miratim rishikimin e buxhetit të Komunës për vitit 2017.

Me 24 vota për, pa kundër, 1 abstenim u miratua rishikimi i buxhetit për vitin 2017.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 12:00.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI



Kryesuesi i Kuvendit,
Dr. Haxhi IBISHI